



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROGRAMI BUXHETIT AFATMESEM
2022-2024
Bashkia DIBËR

Program i Buxhetit Afatmesëm 2022-2024

Bashkia/Qarku Dibër

Tabela lëndës

1 Vështrim i përgjithshëm.....	Error! Bookmark not defined.
1.1 Situata e njësisë së vetëqeverises vendore	
Burimi i informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor / Plani i Zhvillimit Strategjik (PPV/PZhS)	
1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e NJQV-së	
1.3 Informacion financiar themelor	
2 Orientimi afatgjatë njësisë së vetëqeverises vendore.....	
2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale	
2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit.....	
3 Projektet kryesore të PBA-së 2022-2024.....	
3.1 Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit	
3.2 Plani i shpenzimeve kapitale /projektplani 2022-2024	
4 Informacion financiar.....	
4.1 Supozimet e planifikimit	
4.2 Burimet e të ardhurave.....	
4.3 Shpenzimet.....	
4.4 Buxheti total	
4.4 Informacion financiar shtesë.....	
4.4.1 Huamarrje	
4.4.2 Të prapambetura	
4.4.3 Treguesit financiarë	
4.4.4 Rreziqet financiare.....	

5	Informacion për programet buxhetore	
011:	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme	
013:	Shërbime të përgjithshme.....	
031:	Shërbimet policore	
032:	Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri	
036:	Rendi publik dhe masat e sigurisë	
041:	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës.....	
042:	Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia.....	
045:	Transporti	
047:	Industri të tjera	
051:	Menaxhimi i mbetjeve	
056:	Mbrojtja mjedisore,.....	
061:	Zhvillimi i strehimit.....	
062:	Zhvillimi i komunitetit.....	
063:	Furnizimi me ujë	
064:	Ndriçimi i rrugëve.....	
072:	Shërbimet ambulatorë.....	
081:	Shërbimet rekreative dhe sportive	
082:	Shërbime kulturore.....	
091:	Arsimi bazë dhe parashkollor	
092:	Arsimi i mesëm.....	
096:	Shërbimet plotësuese në arsim.....	
101:	Sëmundje dhe paaftësi.....	
102:	Të moshuarit	
104:	Familje dhe fëmijët	
105:	Papunësia.....	

106: Strehimi	
107: Ndihma ekonomike.....	
6 Monitorimi i zbatimit të strategjisë	
6.1 Hyrje – rezultati i përgjithshëm dhe përfundime	
6.2 Lista e masave strategjike për çdo fushë prioritare – statusi i zbatimit	
7 Shtojcë.....	
7.1 Regjistri i aseteve	
7.2 Huatë	
7.3 Garancitë dhe vëllimi i tyre financiar	
7.4 Kontratat Lizing	
7.5 Kontratat Qiraje.....	
7.6 Kontrata me të tretë / Jashtëkontraktimi (outsourcing)	
7.7 Konçesione dhe PPP	
7.8 Shoqëritë në pronësi të njësisë vendore	
7.9 Paketa fiskale	
7.10 Vlerësimi i shpenzimeve të planifikuara si pjesë e paketës fiskale	
7.11 Përshkrimi i metodologjisë së përlllogaritjes së të ardhurave	
7.12 Plani i fluksit monetar	

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Një cilësi më e mirë banimi në territorin e Dibres

Cilësia urbane dhe rajonale i referohet kryesisht cilësisë së jetës së atyre që banojnë në territorin e Dibres, do të thotë i kushton vëmendje pjesëve të ndryshme të territorit dhe marrdhënieve mes sistemeve të ndryshme që e përbëjnë atë: të maleve dhe luginave, zonave urbane dhe fshatrave, poleve qendrore dhe zonave më marxhinale.

Qendrat kryesore dhe fshatrat me te vegjel nga të cilat karakterizohet territori duhet të bëhen vende të socializimit dhe të ofrimit të shërbimeve bazë. Duhet vlerësuar rrugët dhe vendet publike si vende takimi dhe konfrontimi.

Dimensionet e cilësisë së jetës janë të lidhura ngushtë me komponentët e tjerë si ato ekonomike, infrastrukturore, sociale, mjedisore. Cilësia urbane dhe mjedisore nuk lidhet vetëm me aspektet materiale / fizike të qytetit dhe të territorit, por përfshin të gjithë sferën jomateriale të lidhur me mirëqenien lokale. Ajo përshtatet në këtë aspekt me masen e ndryshimeve demografike të lidhura veçanërisht me probleme të mëdha sociale, me shpopullimin e territorit dhe shërbimeve të shperndara me karakter inkluziv dhe social. Në të njëjtën kohë merr rol qendror dhe ofrimi i shërbimeve dhe hapësirave për të rinjtë, me qëllim jo vetëm të ofrojë mundësi për brezin e ri, por edhe për të jetuar dhe shijuar territorin në menyre të përgjegjshme, të vetëdijshme dhe të motivuar.

Indikatore të kyç janë :


1. forcimi i rolit të Dibres si qendër kryesore e funksioneve të rangut rajonal;
2. fuqizimi i lokaliteteve kryesore për të përmbushur kërkesën për shërbime afërsie
3. kualifikimi i shërbimeve bazë në lokalitetet më të vogla /fshatra

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë Dibër

Si çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë Dibër përmendim:

- Nje cilesi me e mire banimi ne territorin e Dibrës.
- Aksesimi me i mirë në zonën e brendshme të Dibrës dhe vlerësimi i lidhjeve ndër-rajonale dhe ndërkufitare.
- Shfrytëzim i qëndrueshëm i burimeve mjedisore si në aspektin e turizmit ashtu dhe të energjisë dhe minierave.
- Vlerësimi i zinxhirit të prodhimit lokal.

Të gjitha keto zhvillime përmbledhen në skemën e mëposhtme sipas objektivave strategjike të çdo fushe që të sinkronizuara bashkë çojnë në hartimin e një PPV multidimensionale dhe zhvillues për zonën :



1.3 Informacion financiar kryesor për Bashkinë Dibër

Për bashkinë Dibër burimet e financimit përbëhen nga :

- **Transferta e pakushtëzuar** e cila është parashikuar nga Ministria e Financave për vitin 2022 në vlerën 416.544 mijë lekë, për vitin 2023 në vlerën 438.691 mijë lekë si dhe për vitin 2024 në vlerën 467.696 mijë lekë
- **Të ardhurat e veta** , të cilat janë planifikuar nga Bashkia Dibër për vitin 2022 në vlerën 151.065 mijë lekë, për vitin 2023 në vlerën 151.065 mijë lekë si dhe për vitin 2024 në vlerën 151.065 mijë lekë
- **Transferta specifike**, e cila është parashikuar nga Ministria e Financave me një vlerë të pandryshuar, 234.873 mijë lekë për vitet 2021-2024.
- **Transferta e kushtëzuar**, e cila është parashikuar për vitin 2022 në vlerën 957.561 mijë lekë, për vitin 2023 në vlerën 958.000 mijë lekë si dhe për vitin 2024 në vlerën 958.000 mijë lekë

BURIMET E FINANCIMIT	2022	2023	2024
TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	416.544	438.691	467.696
ARDHUARAT E VETA	151.065	151.065	151,065
TRANSFERTA SPECIFIKE	234.873	234.873	234.873
TRANSFERTA KUSHTEZUAR	957.561	958.000	958.000
TOTALI	1.760.043	1.728.629	1.811.634

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale

ORIENTIMET TEMATIKE STRATEGJIKE

- ***Urbanistikë dhe infrastrukturë të rilindur për Bashkinë Dibër***

“Dibra në vitin 2030 do të jetë një zonë e pëlqyeshme për banim, me qytetin dhe fshatrat e rivitalizuara dhe me një infrastrukturë lehtësisht të aksesueshme dhe moderne”.

Objektivat strategjike:

OS1: Rigjenerimi i qytetit të Peshkopisë, falë ndërhyrjes në krijimin e qendrave të lulëzuara, me trotuare dhe rrugica të rregullta, artistikisht prekëse, me të gjitha lehtësitë e nevojshme për qytetarët, duke ruajtur vlerat historike, parqet rikreative, me arkitekturë miqësore të pëlqyeshme për banorët dhe vizitorët.

OS2: Fokusimi në zhvillimin e zonave të reja në mënyrë të qëndrueshme në skajet/periferitë e qytetit të Peshkopisë dhe në zonat ku ka pasur më shumë ndërtime të reja, si në aksin Kuben-Peshkopi, Peshkopi-Llixha, Peshkopi-Llasen, Peshkopi-Rruga-Ura dhe Maqellarë-Qendër e Maqellarë-Bllatë.

OS3: Rivitalizimi dhe rigjenerimi i zonave rurale/fshatrave, të qendrave krahinore (që përkojnë me qendrat e Njësive Administrative) dhe fshatrave përgjatë gjithë territorit të Dibrës.

OS4: Sigurimi i cilësisë së lartë në projektimin e ndërtimeve të reja, duke përdorur teknika dhe materiale të reja ndërtimore, duke ruajtur karakteristikat historike dhe standardet e urbanistikës.

OS5: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të transportit publik, duke siguruar akses të plotë për banorët në çdo aks rrugor të brendshëm me qendrën e Peshkopisë dhe interurban me Tiranën, në partneritet me sektorin privat.

OS6: Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemimi i KUZ-së në të gjitha qendrat e banuara.

- ***Dibra e hapur për biznes! Ekonomi konkurruese/zhvillim ekonomik***

“Dibra në vitin 2030 do të ketë një ekonomi të zhvilluar, konkurruese dhe të diversifikuar”

Objektivat strategjike:

OS7: Mbështetja dhe inkurajimi për zhvillimin ekonomik lokal, duke siguruar rritje ekonomike të bizneseve ekzistuese dhe të reja, ekonomive familjare rurale dhe turistike, si dhe shërbimeve, duke investuar në mjedisin e shëndetshëm të informacionit dhe ndërmjetësimin, si dhe në procesin e aftësimin profesional, arsimit dhe kualifikimeve.

OS8: Mbështetja për sektorin bujqësor, si sektori prioritar i zhvillimit të ekonomisë lokale, për të qenë eficient në rendimentin e prodhimit dhe konkurrues me cilësi, sasi dhe çmim në tregun kombëtar dhe atë rajonal.

- ***Është mirë të jesh dibran! Komunitet i qëndrueshëm/zhvillim social***

“Dibranët në vitin 2030 do të jenë të lumtur, do të gjejnë jeta sportive dhe kulturore, shanset e barabarta në marrjen e shërbimeve sociale, në ndjekjen e arsimit të avancuar, ku inkurajohen familjet e qëndrueshme dhe një komunitet i shëndetshëm e i sigurtë.”

Objektivat strategjike:

OS9: Sigurimi i ambienteve dhe lehtësirave publike për nevojat e komunitetit dhe grupeve në nevojë si: të pastrehët, të moshuarit, fëmijët jetimë, gratë, rinia, etj.

OS10: Përmirësimi i cilësisë së jetës, duke rritur mirëqenien, stimuluar një mënyrë jetese sa më të shëndetshme, me akses në ambientet sportive, kulturore dhe shërbim shëndetësor e arsimor të përmirësuar. Bashkia do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të tyre, gjithmonë në shërbim të banorëve.

- ***E gjelbër, e pastër dhe natyrale! Mjedi i qëndrueshëm natyror***

“Dibra në vitin 2030 do të ketë një mjedi natyror të mbrojtur mirë, të promovuar për pasuritë natyrore të saj dhe të pasuruar me ndërhyrje pozitive nga dora e njeriut për mbajtjen pastër të ambienteve dhe ndikimeve klimatike”.

Objektivat strategjike:

OS11: Shtimi dhe sigurimi i burimeve natyrore, falë menaxhimit me efektivitet të tokës, pyjeve, burimeve natyrore, ajrit dhe minimizimit të presionit mbi mjedisin, si mbetjet, zjarret, erozioni, etj.

OS12: Menaxhimi dhe administrimi i mirë i ujërave (nëntokësore dhe sipërfaqësore), falë shtimit të masave mbrojtëse për brigjet e lumenjve dhe përrenjve me qëllim minimizimin e dëmeve, si përmytje dhe katastrofa të tjera ujore.

OS13: Zbutja e ndikimeve negative në ndryshimet klimatike, duke përdorur me eficiencë energjinë, mbrojtja e burimeve ujore dhe emetimi i karbonit (CO₂).

- ***Qeverisje e mirë vendore***

“Dibra do të ketë një qeverisje të mirë vendore, e aftë të orientojë zhvillimin e qëndrueshëm të teritorit, të menaxhojë me efektivitet resurset dhe financat publike; një qeveri që i shërben me cilësi komunitetit, e përgjegjshme dhe e hapur për llogaridhënie ndaj qytetarëve”.

Objektivat strategjike:

OS14: Sigurimi i një qeverisjeje të mirë vendore, transparente dhe bashkëpunuese me qytetarët, sektorin privat, njësitë e tjera vendore dhe ndërkufitare, si dhe me binjakëzime me njësi vendore në Evropë.

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

Anët e Forta

- ☐ Pozicion i favorshëm gjeografik, mundësi për shfrytëzimin e fondeve të BE-së për bashkëpunimin ndërkufitar
- ☐ Peshkopia dhe fshatrat perreth janë zona urbane kompakte.
- ☐ Dibra sipas politikave kombëtare është qendra ndërmjetese e aglomerateve raionale, që nënkupton avantazhe nga prania e zyrave dhe shërbimeve publike.

Dobësitë

- ☐ Ekspansion i paplanifikuar i qendrave urbane me mungese hapësirash publike dhe cilesie urbane
- ☐ Eficencë e ulët në ofrimin e shërbimeve
- ☐ Infrastrukturë arsimore me cilësi të ulët
- ☐ Cilesi e ulët shërbimesh në zonat rurale
- ☐ Zhvillim monocenrik
- ☐ Mungese banesash sociale për grupet vunerabel
- ☐ Mungesa e kompetencave teknike në çështjet e planifikimit urban dhe zbatimit.
- ☐ Mungesa e kompetencave teknike në menaxhimin e burimeve natyrore
- ☐ Mungesa e aftësive teknike në zhvillimin turistik dhe marketingun territorial

Mundësitë

- ☐ Bashkëpunim ekonomik dhe social në nivel rajonal dhe ndërkufitar
- ☐ Zhvillim policentrik me përqendrimin e shërbimeve kryesore në qytetin e Peshkopi
- ☐ Përmirësimin e cilesisë së jetesës në zonat rurale dhe periferike
- ☐ Menaxhimi i integruar i territorit
- ☐ Zbatimi i një bazë të dhënash të gjeo-referencuara për të gjithë territorin, për tu rinovuar dhe monitoruar në kohë
- ☐ Fenomeni i migrimit nga kjo zona drejt Tiranës dhe Durrësit
- ☐ Tendenca e të rinjve për të braktisur zonën
- ☐ Bashkia Dibrë ka një sipërfaqe prej rreth 1000 kilometra katrorë, shumë më e lartë se territori që duhet të menaxhonte përpara reformës administrative.

Vështirësi në ngritjen e kapaciteteve lokale në zonat periferie

- Pabarazi në zhvillimin rajonal krahasuar me vendet fqinj

Vlerësimi dhe parashikimi afatmesëm i të ardhurave për Bashkinë Dibër

A. Raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të veta

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Dibër, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Paketa fiskale e Bashkisë Dibër për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentivuese në taksa:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi deri në 30% nga referenca ligjore
- Taksë 0 (zero) ndërtese për qëllime banimi për invalidët
- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi etj. deri në 30% nga referenca ligjore

Politikat incentivuese dhe uljet nën nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:


- Tarifa minimale deri në zero për shërbimin e ndriçimit publik në zonat rurale
- Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimit e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë.


Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera.

/mijë lekë

	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Të ardhurat e veta	151,065	151,065	151,065
Të Ardhura nga Taksat Vendore	60,480	60,480	60,480
Të Ardhura nga Taksat e Ndara	20,210	20,210	20,210
Te Ardhura nga Tarifat Vendore	44,100	44,100	44,100
Të Ardhura të tjera	26,275	26,275	26,275
Të Ardhura nga Donacionet	0	0	0



Grafiku 1 Të ardhurat nga burimet e veta



Grafiku 2 Ndikimi në planin e të ardhurave, i çdo takse dhe tarife

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta janë kryesisht tarifat për pastrimin që zë rreth 22% të tij, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 33%, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 4%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 7%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 5%, Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 71% të planit të të ardhurave të Bashkisë Dibër.

Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor:

Tabela 1 Të ardhurat e veta të Bashkisë Dibër


	LLOJET E TË ARDHURAVE	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
A	TË ARDHURAT E VETA GJITHSEJ	80,203	81,520	142,341	145,187	148,091	151,065	151,065	151,065	151,065
A.I	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	23,422	17,883	58,315	59,256	60,078	60,480	60,480	60,480	60,480
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për bizne	4,210	787	1,446	2,200	2,800	3,000	3,000	3,000	3,000
I.1.0	Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapamb	-	-	-	-	-	-	-	-	-
I.2	Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	10,611	10,381	47,289	47,326	47,396	47,496	47,496	47,496	47,496
I.3	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	275	38	3,910	3,950	4,100	4,200	4,200	4,200	4,200
I.4	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga	6,866	4,463	5,000	5,100	5,100	5,100	5,100	5,100	5,100
I.5	Të ardhura nga taksa e tabelës	1,460	2,214	670	680	682	684	684	684	684
A.II	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	18,797	14,298	18,643	18,900	19,650	20,210	20,210	20,210	20,210
II.1	Të ardhura nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve	8,558	9,068	10,000	10,100	10,700	11,000	11,000	11,000	11,000
II.2	Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronë	41	47	1,000	1,100	1,150	1,300	1,300	1,300	1,300
II.3	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	-	-	80	100	100	110	110	110	110
II.4	Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	10,198	5,183	7,563	7,600	7,700	7,800	7,800	7,800	7,800
A.III	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	16,402	16,660	38,285	41,436	42,428	44,100	44,100	44,100	44,100
III.1	Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetu	10,901	13,236	30,362	32,106	32,273	33,640	33,640	33,640	33,640
III.2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	4,447	2,331	6,819	7,756	8,491	8,696	8,696	8,696	8,696
III.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	1,054	1,093	1,104	1,574	1,664	1,764	1,764	1,764	1,764
III.4	Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të basi	14,999	13,114	21,224	19,520	19,860	20,200	20,200	20,200	20,200
A.IV	TË ARDHURA TË TJERA	6,583	19,565	5,874	6,075	6,075	6,075	6,075	6,075	6,075
A.V	TË ARDHURA NGA DONACIONET	378	110	-	-	-	-	-	-	-

Tabela e mëposhtme pasqyron në mënyrë analitike ngarkesën fiskale sipas njësive administrative:

Tabela 2
Ngarkesa
fiskale sipas
njësive
administrative

Planifikimi i të ardhurave për vitet 2022-2024, sipas Njësive Administrative / mijë Lekë

Viti	Totali	Peshkopi	Maqellare	Melan	Tomin	Kastriot	Sllove	F.Cidhen	K.Dodes	Muhur	Luzni	Selishte	Arras	Z.Rec	Z.Dardhe	Lure
2022	151,065	118,058	15,400	3,701	3,818	2,120	695	566	481	799	488	942	558	487	616	2,336
2023	151,065	118,058	15,400	3,701	3,818	2,120	695	566	481	799	488	942	558	487	616	2,336
2024	151,065	118,058	15,400	3,701	3,818	2,120	695	566	481	799	488	942	558	487	616	2,336



Grafiku 3. Planifikimi i të ardhurave, sipas njësive administrative

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave i ngarkohet Njesisë administrative Peshkopi, rreth 59% të planit total të të ardhurave, si dhe Njesisë Administrative Maqellare në vlerën rreth 16% të planit total të të ardhurave.

B. Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak.

Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 21,922 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet, me rreth 96%.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.


Tabela 2 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)					
Nr	Bashkia Diber	Familjet	Biznesi i Vogël	Biznesi i madh	Institucione
I	NjA Peshkopi	4535	604	59	23
II	NjA të tjera				0
	NjA Maqellare	3415	117	14	0
	NjA Melan	1143	9	3	0
	NjA Tomin	2259	13	5	0
	NjA Kastriot	2100	13	3	0
	NjA Muhurr	1044	5	3	0
	NjA Slllove	953	3	0	0
	NjA Fushe-Cidhen	1044	3	1	0
	NjA Luzni	838	0	0	0
	NjA Kala e Dodes	810	3	0	0
	NjA Selishte	563	0	3	0
	NjA Arras	1146	2	0	0
	NjA Zall-Dardhe	351	0	1	0
	NjA Lure	478	1	3	0
	NjA Zall-Rec	351	0	1	0
	TOTALI	21030	773	96	23

B.1 Taksapaguesit familjarë

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Dibër është 21,030. Numri i familjeve në njësinë administrative Peshkopi zë peshën kryesore me 4535 familje ose 22% të numrin të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Dibër.

Numri i familjeve taksapaguese sipas vendodhjes



Grafiku 4 Numri i familjeve taksapaguese

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju referuar kapaciteteve reale të familjeve rezidente sipas Censurit.


Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si dhe për familjet që janë përfitues të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët etj.

Më poshtë tabela përmbledhëse për familjet sipas kategorive/lehtësive fiskale dhe sipas Njësisë Administrative:

Tabela 3 Kapaciteti i familjeve taksapaguese

KAPACITETI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE					
Nr	Bashkia Dibër	Totali i familjeve	Familje me tarifa/taksa të plota	Familje me lehtësi fiskale	
				Pensionistë, invalidë, etj.	Përfitues të ndihmës ekonomike
I	NjA Peshkopi	4535	3487	707	341
II	NjA të tjera				
	NjA Maqellare	3415	2447	115	853
	NjA Melan	1143	788	47	308
	NjA Tomin	2259	1693	59	507
	NjA Kastriot	2100	1539	63	498
	NjA Muhurr	1044	793	42	209
	NjA Slllove	953	646	31	276
	NjA Fushe-Cidhen	1044	727	42	275

NjA Luzni	838	526	13	299
NjA Kala e Dodes	810	634	4	172
NjA Selishte	563	421	5	137
NjA Arras	1146	831	22	293
NjA Zall-Dardhe	351	232	6	113
NjA Lure	478	382	8	88
NjA Zall-Rec	351	261	4	86
TOTALI	21030	15407	1168	4455



Grafiku 5 Shpërndarja e Familjeve sipas kategorive të tarifimit

B.2 Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Dibër është 869. Biznesi i vogël zë rreth 90% të numrit total të bizneseve.


Numri i institucioneve që përfshihen në detyrimet fiskale janë rreth 23, të cilat ndodhen në Njësinë Administrative Peshkopi.

Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e vogla vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 87% ndaj totalit të bizneseve të vegjël.

Tabela 4 Kapaciteti i bizneseve te vegjel sipas natyres

KAPACITETI I BIZNESEVE TE VEGJEL SIPAS NATYRES SE TYRE
--

Nr	Bashkia Diber	Biznesi i vogël	Nga kjo :		
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Ambulantë
I	NjA Peshkopi	604	511	43	50
II	NjA të tjera	169	157	12	-
	NjA Maqellare	117	109	8	-
	NjA Melan	9	9	0	-
	NjA Tomin	13	9	4	-
	NjA Kastriot	13	13	0	-
	NjA Muhurr	5	5	0	-
	NjA Slllove	3	3	0	-
	NjA Fushe-Cidhen	3	3	0	-
	NjA Luzni	0	0	0	-
	NjA Kala e Dodes	3	3	0	-
	NjA Selishte	0	0	0	-
	NjA Arras	2	2	0	-
	NjA Zall-Dardhe	0			
	NjA Lure	1	1	0	-
	NjA Zall-Rec	0	0	0	-
	TOTALI	773	668	55	50




Grafiku 6 Numri i bizneseve

Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e mëdha, vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 75% ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj.

Tabela 5 Kapaciteti i bizneseve të mëdha sipas natyrës së tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TE MEDHA SIPAS NATYRES SE TYRE							
Nr	Bashkia Diber	Biznesi i madh	Nga kjo :				
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi tregtare për tregëtim karburanti	Njësi prodhimi	Subjekte ndërtimi	Ente shtetërore, OJF, etj.
I	NjA Peshkopi	59	49	5	0	5	-
	NjA të tjera	37	23	9	1	4	-
	NjA Maqellare	14	8	4	1	1	-
	NjA Melan	3	1	2			-
	NjA Tomin	5	3	2	0	0	-
	NjA Kastriot	3	1	1	0	1	-
II	NjA Muhurr	3	1	-	-	2	-
	NjA Slllove	-	-	-	-	-	-
	NjA Fushe-Cidhen	1	1	-	-	-	-
	NjA Luzni	-	-	-	-	-	-
	NjA Kala e Dodes	-	-	-	-	-	-
	NjA Selishte	3	3	-	-	-	-
	NjA Arras	-	-	-	-	-	-
	NjA Zall-Dardhe	1	1				
	NjA Lure	3	3	-	-	-	-
	NjA Zall-Rec	1	1	-	-	-	-
	TOTALI	96	72	14	1	9	-



Grafiku 7 Kapaciteti i bizneseve sipas natyres

C. Detajimi i të ardhurave sipas zërave, pesha në të ardhurat e bashkisë

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, donacione dhe të ardhurat e tjera.

Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve të sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.


Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Diber nr. 159 date 28.12.2020 ”Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Diber“, i ndryshuar;

C.1 Te ardhurat nga taksat vendore

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Për vitet 2022-2024 parashikohet që të ardhurat nga taksat të përbëjnë rreth 54% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.



Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila zë mbi 33% të totalit të të ardhurave nga taksat e veta.

Grafiku 8 Peshë sipas zërave të të ardhurave nga taksat vendore

Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, date 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 11:

- shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 0 deri në 5 milion është 0 Lekë,
- ndërsa shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 5 milion deri në 8 milion është 5 % e fitimit.

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar, ndërsa 99% kalon në favor të Bashkisë Dibër.

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2022-2024 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë,
- Ndarjes në këste të pagesave,
- shtimit të arkave funksionale më pranë zonave të banuara në njësitë administrative.
- shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarrja, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI etj

a) Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat

Me ndryshimet në ligjin 9632 “Për sistemin e taksave vendore”, me Ligj Nr. 106/2017, date 30.11.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.222, date 19.12.2017, ndryshon shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

b) Të ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Dibër. Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, taksa e çdo kategorie e tokës bujqësore ka një lehtësim që shkon në maksimumin e lejuar ligjor prej 30%.

Më poshtë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore, sipas kategorive të tokës dhe njësive administrative:

Tabela 8 Të ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore

TE ARDHURAT NGA TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE											
I.2.2	Kategorit e e tokes bujqesor e	NjA Peshkopi			NjA Maqellare(4 njesite)			NjA të tjera(10 njesite)			Totali i Siperfaqes (m2)
		Sipërfa qja m2	Niveli i taksë s lekë/ ha	Të ardhu ra	Sipërfa qja m2	Niveli i taksë s lekë/ ha	Të ardhu ra	Sipërfa qja m2	Niveli i taksë s lekë/ ha	Të ardhur a	
1.2. 2.1	I	-	2240		-	2240				2240	
1.2. 2.2	II	-	1680		-	1680		-	1680		-
1.2. 2.3	III	-	1120			1120				1120	
1.2. 2.4	IV	-	1080			1080				1080	
1.2. 2.5	V	-	1000			1000				1000	
1.2. 2.6	VI	-	960		-	960				960	
1.2. 2.7	VII – X	-	880		-	880				880	
	Totali	-									
	Ne % ndaj totali	0%		0%	7%		7%	93%		93%	100%

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi kapacitetin aktual fiskal të njësive administrative, mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore parashikohen me një rritje prej 1% në vit.

c) Të ardhura nga Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e

vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Për bizneset kjo taksë administrohet nga Bashkia Dibër.

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale, dhe mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve. Të ardhurat nga taksa e truallit parashikohen me një rritje prej 1% në vit.

Më poshtë tabela e të ardhurave nga taksa mbi truallin, sipas kategorive të truallit dhe njësive administrative:


Tabela 9 Të ardhura nga Taksa mbi truallin

TE ARDHURAT NGA TAKSA MBI TRUALLIN

1. 2. 3.	Kategorite e truallit	NjA Peshkopi			NjA Maqellare			NjA të tjera			Totali I Siperfaqes (m2)
		Sipërfaqja m2	Nivel i taks lekë/m2	Të ardhura	Sipërfaqja m2	Niveli i taks lekë/m2	Të ardhura	Sipërfaqja m2	Nivel i taks lekë/m2	Të ardhura	
a)	Për qëllime banimi nga individët	0	0.28	0	178,571	0.28	50,000	714,285	0.28	200,000	892,856
b)	Për qëllime biznesi	19,333	15	290,000	16,667	15	250,000	4,000	15	60,000	40,000
	Totali	19,333		290,000	195,238		300,000	718,285		260,000	932,856
	Ne % ndaj totali	2%		34%	21%		35%	77%		31%	100%

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së taksueshme, rreth 77% e totalit, është në Njësitë Administrative. Referuar kategorive të truallit, pjesa më e madhe e të ardhurave të parashikuara nga kjo taksë vjen nga trojet për qëllime biznesi (rreth 71%).

Te ardhurat nga taksat mbi truallin sipas kategorive



Grafiku 9 Të ardhurat nga taksa e truallit, sipas kategorizimit ligjor

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Dibër.

Me “Hotel” kuptohet çdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Tabela 10 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Zonat	Të ardhura nga taksa e fjetjes ne hotel në /000 Lekë		
	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Njësia Peshkopi	3,000	3,000	3,000

Planifikimi i të ardhurave me një rritje prej 3% në vit është bërë duke ju referuar parashikimit të zgjerimit të kapacitetit, rritjes së numrit të njësive, si dhe shtrirjen periudhave të sezoneve turistike për ushtrimin e aktivitetit.

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Dibër.

Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 1-3% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të ndryshme nga ato të përmendura më lart është 4 % të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet.

Bazuar në Ligjin Nr. 9482 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Plani i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi .

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi administrohet nga Bashkia Dibër. Vjelja e kësaj takse paraqet vështirësi për Bashkinë Dibër, për arsye se subjektet dhe familjarët pasi kryejnë procedurat e legalizimit pranë ALUIZNI-it, arrijnë të kryejnë regjistrimin e pronës pa shlyer detyrimin përkatës. Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga Bashkia Dibër, si dhe në mbështetjen nga ZRRPP-ja.

Tabela 11 Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë			
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	Viti 2022 /000 lekë	Viti 2023 /000 lekë	Viti 2024 /000 lekë
Taksa për ndërtimet e reja (përveç sektorit e turizmit, industrisë apo publik)	10,000	10,000	10,000

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Bazuar në Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.


Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Tabela 12 Të ardhura nga Taksa e tabelës

Të ardhura nga taksa e tabelës			
Llojet e tabelave	Viti 2022 /000 lekë	Viti 2023 /000 lekë	Viti 2024 /000 lekë
Tabelë identifikimi, mbi 2 metra katror	0	0	0
Tabela identifikimi jashtë territorit	0	0	0
Tabelë reklamimi, e thjeshtë	650	650	650

Tabelë reklamimi, elektronike	250	250	250
Ekspozimeve , stenda banderola, etj	0	0	0
TOTAL	900	900	900



Grafiku 10 Të ardhurat nga taksa e tabelës, sipas ndarjes ligjore

C.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Të ardhurat nga taksat e ndara bazohen në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 25, Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:

- 6 % e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;
- 53 % e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
- 1 % e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
- 40 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Sipas ligjit, të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

Për vitet 2022-2024 të ardhurat e parashikuara për Bashkinë Dibër nga taksat e ndara përbëjnë rreth 13% të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Bazuar ne ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore ne rolin e agentëve tatimorë, një pjesë e këtyre te ardhurave transferohen në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 25 % e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkinë Dibër.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara referuar të dhënave për nivelet e arkëtimeve.

Tabela 13 Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Të ardhura nga taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura			
	Viti 2022 /000 lekë	Viti 2023 /000 lekë	Viti 2024 /000 lekë
Bashkia Dibër	17,600	17,600	17,600

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit, nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Dibër, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

Tabela 14 Të ardhura nga Taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme			
	Viti 2022 /000 lekë	Viti 2023 /000 lekë	Viti 2024 /000 lekë
Bashkia Dibër	500	500	500

Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Bazuar në nenin 4 i ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, baza e taksës së rentës minerare llogaritet mbi burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Personi fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

